



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 14.05.2019
Ref.: A Nr. 25/2019
770/180

Komisioni Ankesave i Agjencisë së Kosovës për Akreditim, në përbërje të plotë dhe në praninë e procesmbajtësit, në shqyrtimin e ankesës me numër protokolli 435/19H të datës 15.03.2019, të parashtruar nga Kolegji “AAB” në Prishtinë, të parashtruar kundër Vendimit Nr. Ref. 299/19D, datë 22.02.2019 të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë së Kosovës për Akreditim, duke vepruar në bazë të neneve 47, 48 dhe 132 (paragrafi 4) të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare Nr. 20 / 21 qershor 2016) si dhe duke vepruar në pajtim me nenin 22 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (datë 28.09.2018), në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 14.05.2019, mori këtë:

V E N D I M

1. **Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër protokolli 435/19H të datës 15.03.2019, të parashtruar nga Kolegji “AAB” në Prishtinë.
2. **Anulohet** Vendimit Nr. Ref. 299/19D, datë 22.02.2019 të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë së Kosovës për Akreditim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari Komisionit.

A r s y e t i m

Pas deklarimit të stafit akademik të IAL-ve sipas nenit 30 të UA për Akreditim, AKA ka filluar me verifikimin e dokumentacionit të tyre me qëllim të konfirmimit të plotësimit apo jo të kriterëve ligjore për secilin program të studimit. Në mbledhjen e mbajtur me 15 dhe 16 janar 2019, KShC ka analizuar dokumentacionin e secilit staf akademik të vendosur si bartës të programeve nga Kolegji AAB dhe pasi ka analizuar të dhënat rreth numrit të stafit dhe fushat e studimit për secilin program të studimit, KShC me Vendimit Nr. Ref. 299/19D, datë 22.02.2019 të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë së Kosovës për Akreditim ka tërhequr akreditimin e programit të studimit Komunikim Masiv – Gazetari, MA 120 ECTS.

Parashtruesi i ankesës Kolegji “AAB” në Prishtinë, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesën me numër protokolli 435/19H të datës 15.03.2019, të parashtruar kundër Vendimit Nr. Ref. 299/19D, datë 22.02.2019 të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë së Kosovës për Akreditim, me të

cilin vendim është tërhequr akreditimi i programit të Komunikim Masiv – Gazetari, MA 120 ECTS.

KShC bazuar në nenin 131 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pa u shprehur mbi të, të njëjtën e ka referuar për vendimmarrje në Komisionin e Ankesave të AKA-së dhe atë bazuar në paragrafin 5 të nenit 131 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Administrimi i provave: Komisioni i Ankesave i AKA-së ka administruar këto prova:

- 435/19H të datës 15.03.2019, të parashtruar nga Kolegji “AAB” në Prishtinë;
- vendimit Nr. Ref. 299/19D, datë 22.02.2019 të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë së Kosovës për Akreditim për tërheqje të akreditimit të programit për Komunikim Masiv – Gazetari, MA 120 ECTS;
- Vendimin Nr. Ref. 442/18D, datë 18.05.2018 të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë së Kosovës për Akreditim, me të cilin është zgjatur periudha e akreditimit për programin e studimit Komunikim Masiv – Gazetari, MA 120 ECTS për periudhen një (1) vjeçare 1 tetor 2019-30 shtator 2020.

KShC me Nr. Ref. 299/19D, datë 22.02.2019, ka arsyetuar si në vijim:

”Ky program ka 120 ECTS, dhe rrjedhimisht sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program të studimit Kolegji AAB, duhet te ketë te paktën dy staf akademik me gradën akademike PhD me marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha e programit të studimit. Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit akademik të prezantuar nga ky kolegji për këtë program të studimit, u konstatua asnjëri nga bartësit nuk i përket fushës së programit të studimit.

Të dy bartësit e programit të studimit, i përkasin profilit të Shkencave Politike, dhe jo të Komunikimit Masiv dhe Gazetarisë. Kjo është në kundërshtim të plotë me paragrafin 5.3.4 të nenit 26 të UA për Akreditim, sipas së cilës, bartësit e programit duhet të jenë të fushës së programit të studimit.

Ky program është akredituar në vitin 2016 (Vendimi nr.651/16, datë 15.07.2016), me bartësit e programit si në vijim: Arsim Sinani, Aurora Ndrio, Shaip Bytyqi.

Bazuar në pikën dy (2) të nenit 21 të UA për Akreditim, “AKA mund ta rishqyrtoj akreditimin e dhënë në çfarëdo kohe dhe/ apo më pas të tërheq vendimin e saj për akreditim nëse kushtet e dhëna me rastin e akreditimit janë shkelur”. Me këtë rast konsiderohet se ndërrimi i të gjithë bartësve nga momenti i akreditimit, dhe vendosja e personave jo të fushës si bartës të programit të studimit Komunikim Masiv – Gazetari, MA, 120 ECTS, është ndryshim i kushteve të akreditimit, dhe mbi këtë bazë, KShC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.”

Komisioni i Ankesave i AKA-së pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjitha shkresave dhe provave të lëndës si dhe pretendimeve të palës ankuese, ka konstatuar se Vendimi i KShC-së Nr. Ref. 299/19D, datë 22.02.2019 **është i pa bazuar.**

Komisioni i Ankesave i AKA-së pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjitha shkresave dhe provave të lëndës si dhe pretendimeve të palës ankuese dhe ekspertizës ndërkombëtare ka gjetur se ndonëse të dy bartësit e programit të studimit, i përkasin profilit të Shkencave Politike, nga provat

e administruara rezulton se të dy kandidatët kanë përgatitje arsimore dhe kualifikim relevant edhe në fushën e Komunikimit Masiv dhe Gazetarisë. Për më tepër, duke iu referuar edhe mendimit të ekspertit ndërkombëtar z. Prof. Dr. Thomas Bauer, nga Universiteti i Vjenës, Austri, konstatohet se doktoratat e arritura në fushën e Diplomacisë Publike, Shkencave Politike dhe Shkencave Filologjike janë vërtetë të mjaftueshme dhe mund të konsiderohen si adekuate për bartës të programit të Komunikimit Masiv në nivel Master.

Përveç kësaj, Komisioni konstatoi se programi i Komunikimit Masiv në nivel Master është ri-akredituar në vitin 2016 dhe ka akreditim valid deri më 30.09.2022. Komision gjen se akreditimi i këtij programi është bërë në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2013, datë 16.01.2013 ndërkaq vendimi Nr. Ref. 299/19D, datë 22.02.2019 të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë së Kosovës për Akreditim për tërheqje programit të Komunikim Masiv – Gazetari, MA 120 ECTS i referohet Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (datë 28.09.2018) **duke prodhuar efekt juridik retroaktiv lidhur me këtë çështje administrative dhe është në kundërshtim me kërkesat e drejtësisë procedurale dhe sigurisë juridike të palëve në procedurë administrative.** Parimi i sigurisë juridike është njeri prej elementeve themelore të sundimit të ligjit që nënkupton mënjanimin e arbitraritetit me qëllim që të arrihet respektimi dhe garantimi i drejtësisë dhe sigurisë juridike (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në çështjen KI 89/13, Vlerësimi i kushtetutshmerisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. Nr. 74/2011, të 12 marsit 2013*).

Parashtuesi i ankesës Kolegji “AAB” në Prishtinë, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesën me numër protokolli 435/19H të datës 15.03.2019, të parashtuar kundër Vendimit Nr. Ref. 299/19D, datë 22.02.2019 të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë së Kosovës për Akreditim, me të cilin vendim është tërhequr akreditimi i programit Banka, Financa dhe Kontabilitet BA 180 ECTS, dega në Gjakovë dhe Ferizaj.

KShC bazuar në nenin 131 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pa u shprehur mbi të, të njëjtën e ka referuar për vendimmarrje në Komisionin e Ankesave të AKA-së dhe atë bazuar në paragrafin 5 të nenit 131 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Administrimi i provave: Komisioni i Ankesave i AKA-së ka administruar këto prova:

- ankesën 435/19H të datës 15.03.2019, të parashtuar nga Kolegji “AAB” në Prishtinë;
- vendimit Nr. Ref. 299/19D, datë 22.02.2019 të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë së Kosovës për Akreditim për tërheqje programit Banka, Financa dhe Kontabilitet BA 180 ECTS, dega në Gjakovë dhe Ferizaj;
- Vendimin Nr. Ref. 442/18D, datë 18.05.2018 të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë së Kosovës për Akreditim, me të cilin është zgjatuar periudha e akreditimit për programin e studimit Banka, Financa dhe Kontabilitet BA 180 ECTS, dega në Gjakovë dhe Ferizaj për periudhën një (1) vjeçare 1 tetor 2020 -30 shtator 2021.

KShC me Nr. Ref. 299/19D, datë 22.02.2019, ka arsyetuar si në vijim:

“Ky program ka 180 ECTS, dhe rrjedhimisht sipas nenit 26, pika 5.3.4 dhe 5.3.9 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program të studimit Kolegji AAB, duhet

te ketë te paktën tre staf akademik me gradën akademike PhD me marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha e programit të studimit.

Sipas nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), Institucionet e Arsimit të Lartë: "Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit"
Andaj bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara me lartë, KSHC vendosi që në mungesë të stafit të fushës së programit të studimit sipas pikës 5.3.4 të nenit 26 dhe pikës dy (2) të nenit 21 të Udhëzimit Administrativ për Akreditim, ta tërheq akreditimin për programin e studimit Banka, Financa dhe Kontabilitet, BA, 180 ECTS, (dega në Gjakovë).

Ankuesi pretendon se me rastin e akreditimit të këtij programi më 07.05.2015 nuk është kërkuar nga AKA që të zbatohet kriteri i bartësve të programit pasi Udhëzimi Administrativ që ka qenë në fuqi në kohën e akreditimit nuk ka përcaktuar se duhet të ekzistojnë bartësit e programit pasi të njëjtit janë mbuluar nga qendra. Ankuesi pretendon se ky vendim ka prodhuar efekte juridike prapavepruese që është në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike.

Komisioni i Ankesave i AKA-së pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjitha shkresave dhe provave të lëndës si dhe pretendimeve të palës ankuese, ka konstatuar se Vendimi i KShC-së Nr. Ref. 299/19D, datë 22.02.2019 është i pa bazuar.

Komisioni konstatoi se programi Banka, Financa dhe Kontabilitet BA 180 ECTS, dega në Gjakovë dhe Ferizaj është akredituar më datë 07.05.2015 dhe ka akreditim valid deri më 30.09.2021. Komision gjen se akreditimi i këtij programi është bërë në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2013, datë 16.01.2013 ndërkaq vendimi Nr. Ref. 299/19D, datë 22.02.2019 të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë së Kosovës për Akreditim për tërheqje programit Banka, Financa dhe Kontabilitet BA 180 ECTS, dega në Gjakovë dhe Ferizaj i referohet Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (datë 28.09.2018) **duke prodhuar efekt juridik retroaktiv lidhur me këtë çështje administrative që është në kundërshtim me kërkesat e drejtësisë procedurale dhe sigurisë juridike të palëve në procedurë administrative.** Parimi i sigurisë juridike është njeri prej elementeve themelore të sundimit të ligjit që nënkupton mënjanimin e arbitraritetit me qëllim që të arrihet respektimi dhe garantimi i drejtësisë dhe sigurisë juridike (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në çështjen KI 89/13, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. Nr. 74/2011, të 12 marsit 2013*).

Për më tepër Komisioni vë në pah edhe kërkesën për pritshmëri të ligjshme dhe të arsyeshme siç përcaktohet me nenin 8 (Parimi i pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme) të Ligjit Nr. 05/L -031 për procedurën e përgjithshme administrative që parasheh se: "1. Veprimet e organeve publike duhet të jenë të parashikueshme dhe të respektojnë pritshmëritë legjitime dhe të arsyeshme të personave. 2. Një veprim administrativ nuk mund të ndryshojë në mënyrë të pajustificuar nga një praktikë administrative e mëparshme e të njëjtit organ për raste të njëjta a të ngjashme".

Parashtruesi i ankesës Kolegji “AAB” në Prishtinë, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesën me numër protokolli 435/19H të datës 15.03.2019, të parashtruar kundër Vendimit Nr. Ref. 299/19D, datë 22.02.2019 të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë së Kosovës për Akreditim, me të cilin vendim është tërhequr akreditimi i programit Gjuhë Angleze, BA 180 ECTS (Dega në Gjakovë).

KShC bazuar në nenin 131 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pa u shprehur mbi të, të njëjtën e ka referuar për vendimmarrje në Komisionin e Ankesave të AKA-së dhe atë bazuar në paragrafin 5 të nenit 131 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Administrimi i provave: Komisioni i Ankesave i AKA-së ka administruar këto prova:

- ankesën 435/19H të datës 15.03.2019, të parashtruar nga Kolegji “AAB” në Prishtinë;
- vendimit Nr. Ref. 299/19D, datë 22.02.2019 të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë së Kosovës për Akreditim për tërheqje të programit Gjuhë Angleze, BA 180 ECTS (Dega në Gjakovë);
- Vendimin Nr. Ref. 442/18D, datë 18.05.2018 të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë së Kosovës për Akreditim, me të cilin është zgjatur periudha e akreditimit për programin e studimit Banka, Financa dhe Kontabilitet BA 180 ECTS, dega në Gjakovë dhe Ferizaj për periudhen një (1) vjeçare 1 tetor 2020 -30 shtator 2021.

KShC me Nr. Ref. 299/19D, datë 22.02.2019, ka arsyetuar si në vijim:

“Gjuhe Angleze, BA, 180 ECTS (dega në Gjakovë), si bartës të këtij programi, Kolegji AAB ka paraparë këta persona: Besa Hoxha-Beqiri, Venera Lllunji, dhe Shevqet Zekolli. Ky program ka 180 ECTS, dhe rrjedhimisht sipas nenit 26, pika 5.3.4 dhe 5.3.9 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program të studimit Kolegji AAB, duhet të ketë te paktën tre staf akademik me gradën akademike PhD me marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha e programit të studimit. Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit akademik të prezantuar nga Kolegji AAB për këtë program të studimit, u konstatua që asnjëri nga stafi i prezantuar për këtë program të studimit nuk është i fushës, siç është natyra e programit të studimit. Besa Hoxha Beqiri është PhD në Studime Letrare, Venera Lllunji është PhD në Shkenca Sociale, Profili: Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare, fushë kjo e cila nuk ka të bëjë asgjë me fushën e programit të studimit, dhe Shevqet Zekolli është PhD në Shkencat Filologjike. Bazuar në atë çka u tha me sipër, asnjëri nga tre bartësit nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë bartës i këtij programi të studimit. Bazuar në pikën dy (2) të nenit 21 të UA për Akreditim, AKA ka shqyrtuar vendimin e dhen për këtë program të studimit, dhe pasi u konfirmua që asnjëri nga bartësit nuk i përket fushës së programit të studimit Gjuhe Angleze, KShC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi. Andaj bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara me lartë, KSHC vendosi që në mungesë të stafit të fushës së programit të studimit sipas pikës 5.3.4 të nenit 26 dhe pikës dy (2) të nenit 21 të Udhëzimit Administrativ për Akreditim, ta tërheq akreditimin për programin e studimit Gjuhe Angleze, BA, 180 ECTS (dega në Gjakovë)”.

Komisioni konstatoi se ky program është akredituar me vendimin nr. 651/2016 datë 15.07.2016 dhe ka akreditim valid deri më 30.09.2022. Komision gjen se akreditimi i këtij programi është bërë në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2013, datë 16.01.2013 ndërkaq vendimi Nr. Ref. 299/19D, datë 22.02.2019 i Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë së Kosovës për Akreditim për tërheqje të programit Gjuhe Angleze, BA, 180 ECTS (dega në Gjakovë) i referohet Udhëzimit

Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (datë 28.09.2018) **duke prodhuar efekt juridik retroaktiv lidhur me këtë çështje administrative që është në kundërshtim me kërkesat e drejtësisë procedurale dhe sigurisë juridike të palëve në procedurë administrative.** Parimi i sigurisë juridike është njeri prej elementeve themelore të sundimit të ligjit që nënkupton mënjanimin e arbitraritetit me qëllim që të arrihet respektimi dhe garantimi i drejtësisë dhe sigurisë juridike (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në çështjen KI 89/13, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. Nr. 74/2011, të 12 marsit 2013*).

Për më tepër Komisioni vë në pah edhe kërkesën për pritshmëri të ligjshme dhe të arsyeshme siç përcaktohet me nenin 8 (Parimi i pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme) të Ligjit Nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative që parasheh se: “1. Veprimet e organeve publike duhet të jenë të parashikueshme dhe të respektojnë pritshmëritë legjitime dhe të arsyeshme të personave. 2. Një veprim administrativ nuk mund të ndryshojë në mënyrë të pajustificuar nga një praktikë administrative e mëparshme e të njëjtit organ për raste të njëjta a të ngjashme”.

Parashtruesi i ankesës Kolegji “AAB” në Prishtinë, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesën me numër protokolli 435/19H të datës 15.03.2019, të parashtruar kundër Vendimit Nr. Ref. 299/19D, datë 22.02.2019 të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë së Kosovës për Akreditim, me të cilin vendim është tërhequr akreditimi i programit a) Menaxhment dhe Informatikë, BSC 180 ECTS (Dega në Ferizaj), b) Përkujdesi dhe mirëqenie e fëmijëve, BA 240 ECTS (dega në Ferizaj) dhe c) Përkujdesi dhe mirëqenie e fëmijëve, BA 240 ECTS (dega në Gjakovë).

KShC bazuar në nenin 131 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pa u shprehur mbi të, të njëjtën e ka referuar për vendimmarrje në Komisionin e Ankesave të AKA-së dhe atë bazuar në paragrafin 5 të nenit 131 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Administrimi i provave: Komisioni i Ankesave i AKA-së ka administruar këto prova:

- ankesën 435/19H të datës 15.03.2019, të parashtruar nga Kolegji “AAB” në Prishtinë;
- vendimit Nr. Ref. 299/19D, datë 22.02.2019 të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë së Kosovës për Akreditim për tërheqje të programeve: a) Menaxhment dhe Informatikë, BSC 180 ECTS (Dega në Ferizaj), b) Përkujdesi dhe mirëqenie e fëmijëve, BA 240 ECTS (dega në Ferizaj) dhe c) Përkujdesi dhe mirëqenie e fëmijëve, BA 240 ECTS (dega në Gjakovë).

KShC me Nr. Ref. 299/19D, datë 22.02.2019, ka arsyetuar si në vijim:

“Për programin e studimit: Menaxhment dhe Informatikë, BSc, 180 ECTS, (dega në Ferizaj), si bartës të këtij programi, Kolegji AAB ka paraparë këta persona: Nazmi Iballi (PhD në Filozofi, Organizimi dhe qeverisja jashtë sferës së prodhimit material / Sigurimi i Informacionit), Alban Asllani, Gezim Selimi (PhD në Shkenca Ekonomike), Jusuf Fejza (PhD në Fushën e Sigurimeve). Ky program ka 180 ECTS, dhe rrjedhimisht sipas nenit 26, pika 5.3.4 dhe 5.3.9 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program të studimit Kolegji AAB, duhet të ketë të paktën tre staf akademik me gradën akademike PhD me marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha e programit të studimit.

Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit akademik të prezantuar nga Kolegji AAB për këtë program të studimit, u konstatua vetëm Gezim Selimi i plotëson kriteret për të qenë bartës i këtij programi të studimit. Nazmi Iballi (PhD në Filozofi, Organizimi dhe qeverisja jashtë sferës së prodhimit material / Sigurimi i Informacionit), Jusuf Fejza, PhD në Fushën e Sigurimeve, nuk i përkasin fushës së studimit të programit të studimit, Menaxhment dhe Informatike, dhe si rrjedhojë nuk mund të jenë bartës të programit të studimit. Bazuar në pikën dy (2) të nenit 21 të UA për Akreditim, AKA ka shqyrtuar vendimin e dhen për këtë program të studimit, dhe pasi u konfirmua që asnjëri nga bartësit nuk i përket fushës së programit të studimit Menaxhment dhe Informatike, BSc, 180 ECTS, (dega në Ferizaj), KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi. Andaj bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara me lartë, KSHC vendosi që në mungesë të stafit të fushës së programit të studimit sipas pikës 5.3.4 të nenit 26 dhe pikës dy (2) të nenit 21 të Udhëzimit Administrativ për Akreditim, ta tërheq akreditimin për programin e studimit Menaxhment dhe Informatike, BSc, 180 ECTS, (dega në Ferizaj).

Për programin e studimit: Përkujdesi dhe Mirëqenie e Fëmijëve, BA, 240 ECTS, (dega në Ferizaj), si bartës të këtij programi, Kolegji AAB ka paraparë këta persona: Hysen Kasumi (PhD në Shkenca Sociale, profili: Psikologji dhe Pedagogji), Nalan Kazaz (PhD në Psikologji dhe Edukim), Arif Shala (PhD në Pedagogji), dhe Tahir Latifi (PhD në Histori dhe Antropologji). Ky program ka 240 ECTS, dhe rrjedhimisht sipas nenit 26, pika 5.3.4 dhe 5.3.9 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program të studimit Kolegji AAB, duhet të ketë të paktën tre staf akademik me gradën akademike PhD me marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha e programit të studimit.

Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit akademik të prezantuar nga Kolegji AAB për këtë program të studimit, u konstatua që Tahir Latifi është PhD në Histori dhe Antropologji, fushë kjo e cila nuk ka të bëjë asgjë me programin e studimit Përkujdesi dhe Mirëqenie e Fëmijëve, dhe si rrjedhojë nuk mund të jenë bartës i këtij programi të studimit. Andaj bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara me lartë, KSHC vendosi që në mungesë të stafit të fushës së programit të studimit sipas pikës 5.3.4 të nenit 26 dhe pikës dy (2) të nenit 21 të Udhëzimit Administrativ për Akreditim, ta tërheq akreditimin për programin e studimit Përkujdesi dhe Mirëqenie e Fëmijëve, BA, 240 ECTS, (dega në Ferizaj).

Për programin e studimit: Përkujdesi dhe Mirëqenie e Fëmijëve, BA, 240 ECTS, (dega në Gjakovë), Kolegji AAB ka paraparë këta persona: Fadil Latifi (PhD në Filologji, Gjuhë Shqipe dhe Letërsi), Gentiana Shahini (PhD në Filologji, Gjuhë Shqipe dhe Letërsi), Rita Loloci (PhD në Filozofi), Qerim Kastrati (PhD në Gjeografi). Ky program ka 240 ECTS, dhe rrjedhimisht sipas nenit 26, pika 5.3.4 dhe 5.3.9 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program të studimit Kolegji AAB, duhet të ketë të paktën katër staf akademik me gradën akademike PhD me marrëdhënie të

rregullt të punës nga fusha e programit të studimit. Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit akademik të prezantuar nga Kolegji AAB për këtë program të studimit, u konstatua që Rita Loloci është PhD në Filozofi, ndërsa Qerim Kastrati është PhD në Gjeografi. Këto fusha të studimit nuk kanë të bëjë me programin e studimit Përkujdesi dhe Mirëqenie e Fëmijëve, dhe si rrjedhojë, të njëjtit nuk mund të jenë bartës i këtij programi të studimit. Andaj bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara me lartë, KSHC vendosi që në mungesë të stafit të

fushës së programit të studimit sipas pikës 5.3.4 të nenit 26 dhe pikës dy (2) të nenit 21 të Udhëzimit Administrativ për Akreditim, ta tërheq akreditimin për programin e studimit Përkujdesi dhe Mirëqenie e Fëmijëve, BA, 240 ECTS, (dega në Gjakovë)."

Komisioni konstatoi se programet e tërhequra janë akredituar sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2013, datë 16.01.2013 ndërsa vendimi Nr. Ref. 299/19D, datë 22.02.2019 i Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë së Kosovës për Akreditim për tërheqje të programeve i referohet Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (datë 28.09.2018) **duke prodhuar efekt juridik retroaktiv lidhur me këtë çështje administrative që është në kundërshtim me kërkesat e drejtësisë procedurale dhe sigurisë juridike të palëve në procedurë administrative. Parimi i sigurisë juridike është njeri prej elementeve themelore të sundimit të ligjit që nënkupton mënjanimin e arbitraritetit me qëllim që të arrihet respektimi dhe garantimi i drejtësisë dhe sigurisë juridike (shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në çështjen KI 89/13, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. Nr. 74/2011, te 12 marsit 2013).**

Për më tepër Komisioni vë në pah edhe kërkesën për pritshmëri të ligjshme dhe të arsyeshme siç përcaktohet me nenin 8 (**Parimi i pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme**) të Ligjit Nr. 05/L -031 për procedurën e përgjithshme administrative që parasheh se: "1. Veprimet e organeve publike duhet të jenë të parashikueshme dhe të respektojnë pritshmëritë legjitime dhe të arsyeshme të personave. 2. Një veprim administrativ nuk mund të ndryshojë në mënyrë të pajustificuar nga një praktikë administrative e mëparshme e të njëjtit organ për raste të njëjta a të ngjashme".

Këshilla juridike: Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente (Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Vendimi i Komisionit të Ankesave është përfundimtar dhe se inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndal ekzekutimin e këtij vendimi.

Komisioni Ankesave i Agjencisë së Kosovës për Akreditim


Lënda me numër A Nr. 25/2019

Datë: 14.05.2019

Kryetari i Komisionit:
Shykrane Gërmizaj



Procesmbajtësi:
Leona Kovaci



Vendimi i dërgohet:

- Palës ankuese;
- Agjencisë së Kosovës për Akreditim;
- Arkivit.